

VENDIM
Nr. 837, datë 26.12.2024

PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË BANESAVE INDIVIDUALE NË BASHKITË DURRËS, KAMZË, MIRDITË, SHIJAK, KRUIJË DHE VORË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, 25 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 97, datë 7.12.2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 1 421 144 250 (një miliard e katërqind e njëzet e një milionë e njëqind e dyzet e katër mijë e dyqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit të banesave individuale për ata individë, të cilët përfitojnë nga grantet e rindërtimit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte që duhen rindërtuar nga e para, në bazë të aktekspertizave të thëlluara, në bashkitë Durrës, Kamzë, Mirditë, Shijak, Kruijë dhe Vorë, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Bashkisë Durrës, në masën 341 609 690 (treqind e dyzet e një milionë e gjashtëqind e nëntë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë) lekë pa TVSH;

b) Bashkisë Kamzë, në masën 173 720 000 (njëqind e shtatëdhjetë e tre milionë e shtatëqind e njëzet mijë) lekë pa TVSH;

c) Bashkisë Mirditë, në masën 126 653 347 (njëqind e njëzet e gjashtë milionë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tre mijë e treqind e dyzet e shtatë) lekë pa TVSH;

ç) Bashkisë Shijak, në masën 116 705 361 (njëqind e gjashtëmbëdhjetë milionë e shtatëqind e pesë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e një) lekë pa TVSH;

d) Bashkisë Kruijë, në masën 310 460 416 (treqind e dhjetë milionë e katërqind e gjashtëdhjetë mijë e katërqind e gjashtëmbëdhjetë) lekë pa TVSH;

dh) Bashkisë Vorë, në masën 351 995 436 (treqind e pesëdhjetë e një milionë e nëntëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e katërqind e tridhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.

2. Përdorimin e fondit të rindërtimit, për vitin 2024, nga bashkitë Durrës, Kamzë, Mirditë, Shijak, Kruijë dhe Vorë, në masën 919 202 014,60 (nëntëqind e nëntëmbëdhjetë milionë e dyqind e dy mijë e katërmbëdhjetë presje gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit të banesave individuale për ata individë, të cilët përfitojnë nga grantet e rindërtimit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte që duhen rindërtuar nga e para, në bazë të aktekspertizave të thëlluara, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Bashkisë Durrës i transferohet fondi, në masën 204 965 814 (dyqind e katër milionë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e katërmbëdhjetë) lekë pa TVSH;

b) Bashkisë Kamzë i transferohet fondi, në masën 173 720 000 (njëqind e shtatëdhjetë e tre milionë e shtatëqind e njëzet mijë) lekë pa TVSH;

c) Bashkisë Mirditë i transferohet fondi, në masën 126 653 347 (njëqind e njëzet e gjashtë milionë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tre mijë e treqind e dyzet e shtatë) lekë pa TVSH;

ç) Bashkisë Shijak i transferohet fondi, në masën 70 023 216,60 (shtatëdhjetë milionë e njëzet e tre mijë e dyqind e gjashtëmbëdhjetë presje gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH;

d) Bashkisë Krujë i transferohet fondi, në masën 132 642 375 (njëqind e tridhjetë e dy milionë e gjashtëqind e dyzet e dy mijë e treqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH;

dh) Bashkisë Vorë i transferohet fondi, në masën 211 197 262 (dyqind e njëmbëdhjetë milionë e njëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e dy) lekë pa TVSH.

3. Efekti financiar, për vitin 2024, përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2024, dhe i transferohet bashkive Durrës, Kamzë, Mirditë, Shijak, Krujë dhe Vorë, në formën e transfertës së pakushtëzuar.

4. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe bashkitë Durrës, Kamzë, Mirditë, Shijak, Krujë dhe Vorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama